

# Bashkimi bën energjinë

Dhjetor 2014

Analizë e tregut të përbashkët energjetik

Seria e analizave mbi  
integrimin ekonomik  
**Kosovë - Shqipëri #3**

INSTITUTE FOR ADVANCED STUDIES

doogapod

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
1. Sfondi i marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve në fushën e energjisë.....	4
2. Karakteristikat e dy sistemeve energjetike dhe mundësia e bashkëpunimit .....	6
2.1 Karakteristikat e sistemeve energjetike .....	6
2.2 Mundësitë dhe përfitimet nga bashkëpunimi .....	7
2.3 Bashkëpunimi institucional.....	8
3. Efektet anësore të bashkëpunimit: shqetësimet për ambientin.....	10
4. Përfundim dhe rekomandime.....	12

## Hyrje

Në vitin 2002, në Athinë të Greqisë, Kosova e përfaqësuar nga UNMIK, bashkë me Shqipërinë dhe vendet tjera të Ballkanit, nënshkruan marrëveshjen e mirëkuptimit me të cilën do të duhej që të intensifikohej bashkëpunimi rajonal në aspektin energjetik.<sup>1</sup> Në vitin 2005 u nënshkrua edhe traktati i Athinës me të cilën formohet Komuniteti i Energjisë,<sup>2</sup> i cili për qëllim ka aplikimin e disa rregullave energjetike të Bashkimit Evropian (BE) në vendet e Ballkanit dhe krijimin e një tregu të përbashkët energjetik ndërmjet këtyre vendeve.

Mirëpo, përveç politikave të Komunitetit të Energjisë për hapjen e tregut Ballkanik në fushën e energjisë, Kosova dhe Shqipëria kanë më shumë arsye të intensifikojnë bashkëpunimin ndërmjet vete në fushën e energjisë. Sistemet e tyre janë komplementare apo plotësuese për njëra tjetrën dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre mund të sjellë shumë përmirësime në efikasitet, optimizim dhe ekonomizim më të mirë të përdorimit të burimeve energjetike.

Në deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përcaktohen edhe çështjet energjetike. Mirëpo, ky nuk është dokumenti i parë ku shprehet interesimi i të dy vendeve për bashkëpunim ndërmjet vete dhe për mundësinë e krijimit të një tregu të përbashkët energjetik. Në njërën anë, Qeveria e Shqipërisë ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2013-2022, në të cilën shpreh interesimin për krijimin e një tregu të përbashkët; në anën tjetër një gjë të tillë e bën edhe draft Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2013-2022, e cila është aprovuar në qeveri, por nuk ka arritur të aprovohet në kuvend.<sup>3</sup>

Mirëpo, përveç mundësive të përfitimit nga bashkëpunimi energjetik i të dy vendeve, ekziston edhe rreziku i interpretimit shumë të ngushtë të idesë së eksplotimit të avantazheve krahasuese të të dy vendeve. Ky rrezik vjen prej mendësisë që Kosova duhet të ndërton kapacitete të mëdha energjetike të bazuara në linjit për faktin që ato kapacitete do të komplementonin kapacitetet hidrike të Shqipërisë. Instituti GAP përkrah fuqishëm integrimin e sistemeve të të dy

<sup>1</sup> Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Tregun Regjional të Energjisë në Evropën Juglindore dhe integrimi i tij në Tregun e Përbashkët të BE. Burimi: <http://bit.ly/1wmZuz5>

<sup>2</sup> Traktati për Themelimin e Komunitetit të Energjisë. Burimi: <http://bit.ly/ORIAFK>

<sup>3</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi 07/180, 23 mars 2014. Burimi: <http://bit.ly/1G6sZ9B>

vendeve apo edhe krijimin e një tregu të përbashkët të energjisë, por kundërshton idenë e eksploatimit të linjitet për hir të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Kjo vjen pas faktorizimit të efekteve negative të eksternaliteteve të prodhimit të energjisë nga burimet e linjitet, si ndotja e ambientit nga pluhuri dhe gazrat, ndikimi negativ i ndotjes në shëndetin publik, dhe problemet me zhvendosjen e popullsisë për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe hapjen e minierave të reja të linjitet.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë mundësitë e bashkëpunimit në fushën e energjisë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Punimi do të tentojë të analizojë dhe elaborojë përfitimet potenciale nga bashkëpunimi, duke shfrytëzuar komplementaritetin e të dy sistemeve, situatën momentale të bashkëpunimit dhe punën deri më tash të institucioneve rreth inkurajimit të bashkëpunimit ndërmjet të dy vendeve. Theks i veçantë do t'i kushtohet efekteve të mundshme negative në fushën e ambientit, shëndetësisë dhe aspekteve sociale të bashkëpunimit.

## 1. Sfondi i marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve në fushën e energjisë

Sistemet energjetike të të dy vendeve hovin më të madh të zhvillimit të tyre e patën pas viteve 1960, edhe pse fillimi i ndërtimit të sistemit energjetik kishte filluar qysh në vitet 1920.<sup>4</sup> Në Kosovë, në vitin 1962 filloi punën blloku i parë me kapacitet 65 MW i termocentralit Kosova A, kurse në Shqipëri 4 vite më parë kishte filluar së punuari hidrocentrali i Ulëzit me kapacitet 25 MW. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe filloi edhe ndërtimi i rrjetit të transmisionit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Për shkak të rezervave të mëdha të linjitet, në Kosovë u ndërtuan kapacitete të mëdha energjetike. Me elektricitet të prodhuar në Kosovë nuk u furnizuan vetëm qytetaret e Kosovës, por edhe qytetaret e republikave tjera të ish-Jugosllavisë. Gjithashtu, për shkak të pozitës gjeografike të saj, e vendosur në mes të Serbisë, Malit të Zi, dhe Maqedonisë, Kosova shërbeu edhe si vend tranzit i energjisë elektrike. Të dy këta faktorë ndikuan që të ndërtohen gjithashtu kapacitete të mëdha të transmisionit të energjisë. m.<sup>5</sup> Në këtë mënyrë,

<sup>4</sup> Fillimet e Energjisë. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare. Burimi: <http://bit.ly/1ysQWXr>

<sup>5</sup> Raporti Vjetor 2013. Zyra e Rregullatorit të Energjisë Kosovë. Burimi: <http://bit.ly/12D7AW1>

sot Kosova është në një udhëkryq energjetik, mbi të cilën rrjedha energjetike konsiderohet të jetë mbi 62% e konsumit të brendshëm.<sup>6</sup>

Në anën tjetër, Shqipëria, edhe pse ka kapacitete të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e importit,<sup>7</sup> ka më pak kapacitete të transmisionit që e ndërlidhin atë me shtetet fqinje. Shqipëria është e lidhur me dy linja me Malin e Zi, 220 kV dhe 400 kV; një linje me Kosovën prej 220 kV; dhe me dy linja me Greqinë, 400 kV dhe 150 kV.<sup>8</sup> Një ndër arsyet për këtë është izolimi politik i Shqipërisë së viteve 1945-1991, sistemi fleksibil i gjenerimit të energjisë nga uji, dhe mungesa e tepricave apo mungesave të mëdha energjetike në Shqipëri.

Meqë sistemet energjetike të të dy vendeve morën hovin gjatë një periudhe kur marrëdhëniet politike ndërmjet ish-Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishin të ftohta, edhe bashkëpunimi energjetik ishte i limituar. Gjithashtu, për shkak të gjendjes politike, energjetika kosovare u drejtua kryesisht drejt republikave tjera të ish-Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, përkundër faktit që të dy sistemet energjetike ishin komplementare, zhvillimi i sektorit energjetik mori një rrugë tjetër.

Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, u bë edhe shpërbërja e sistemeve energjetike, me ç'rast u ul edhe bashkëpunimi rajonal. Mirëpo, për shkak të dinamikës së re politike në Ballkan, bashkëpunimi energjetik Kosovë - Shqipëri u intensifikua. Shkëmbimet energjetike ndërmjet dy vendeve u rriten dhe u planifikua edhe rritja e kapaciteteve të transmisionit ndërmjet dy vendeve. Gjithashtu, filluan të bëhen studime dhe diskutime rreth mundësive të bashkëpunimit të të dy vendeve dhe realizimi i projekteve konkrete.

Në fund të vitit 2013, pas disa viteve shtyrje dhe mos pajtimeve rreth procedurave tenderuese, filloi ndërtimi i linjës 400 kV e cila e ka pikënisjen në Obiliq të Kosovës dhe përfundon në Tiranë të Shqipërisë.<sup>9</sup> Mirëpo, rruga e ndërtimit të linjës interkonjektive që bashkon sistemin energjetik të Kosovës dhe Shqipërisë ishte e gjatë. Punimet konkrete për ndërtimin e kësaj linje filluan qysh pas

<sup>6</sup> List Of New Transmission Capacities And Interconnection Lines (2009-2015), KOSTT, 2009. Burimi: <http://bit.ly/1wn1reV>

<sup>7</sup> Raport Vjetor: Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2013, Enti i Rregullatorit të Energjisë, 2013. Burimi: <http://bit.ly/1s3EI63>

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Qeveria miraton linjën energjetike Shqipëri- Kosovë. Ministria e Energjisë dhe Industrisë. Burimi: <http://bit.ly/1s3F78p>

përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999. Bazuar në Marrëveshjen e Fondit të Trustit e nënshkruar në mes të UNMIK-ut dhe Bankës Botërore në fillim të vitit 2001, një ekip i brendshëm i konsulentëve kishte analizuar tri opsione për rritjen e shkëmbimeve të energjisë elektrike ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.<sup>10</sup> Opsionet e analizuara ishin: 1) ndërtimi i një linje 220 kV, 2) ndërtimi i një linje 400 kV, dhe 3) ndërtimi i një linje 400 kV në drejtim të Podgoricës, Malit të Zi, prej nga do të vinte edhe energjia elektrike në Kosovë. Prej këtyre opsioneve, linja 400 kV kishte rezultuar të jetë superiore karshi opsioneve tjera. Ndërsa vlen të theksohet që opsioni i parë, i ndërtimit të linjës 220 kV, kishte rezultuar të mos jetë i zbatueshëm pasi që kapaciteti i linjës interkonjektive ishte shumë i vogël për të përballuar volumin e madh të paraparë të shkëmbimeve energjetike ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Mirëpo, edhe pse përgjatë viteve ndërtimi i kësaj linje kishte marrë mbështetjen e pothuajse të gjithë institucioneve, duke përfshirë edhe Qeverinë e Kosovës e cila kishte nxjerrë vendim për shpalljen e ndërtimit të saj si interes të përgjithshëm<sup>11</sup> dhe Bankën Zhvillimore Gjermane KfW e cila kishte premtuar financimin e saj, tenderi kishte dështuar disa herë radhazi. Dyshimet për vonimin e këtij projekti ranë mbi aferat korruptive.<sup>12</sup>

## 2. Karakteristikat e dy sistemeve energjetike dhe mundësia e bashkëpunimit

### 2.1 Karakteristikat e sistemeve energjetike

Sistemet energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë kanë tipare karakteristike sa i përket strukturës së gjenerimit të energjisë elektrike. Të dy sistemet janë të bazuara pothuajse 100% në një burim të vetëm të energjisë. Kosova në vitin 2013 kishte prodhuar 97.6% të energjisë elektrike nga termocentralet e bazuara në linjit, ndërsa Shqipëria në të njëjtin vit kishte prodhuar 100% të energjisë nga hidrocentralet<sup>13</sup>. Mirëpo, varshmëria prej 100% tek një burim i vetëm i energjisë rezulton në efikasitet të ulët, kosto më të larta dhe mungesë të stabilitetit.

<sup>10</sup> Energy Sector Technical Assistance Project Kosovo. UNMIK, World Bank. Burimi: <http://bit.ly/1G6tYXf>

<sup>11</sup> Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 04/140. Burimi: <http://bit.ly/1uaO4Hk>

<sup>12</sup> Për më shumë rreth këtyre ngjarjeve, shih portalin Power Games: The dark side of energy deals in the Balkans. Burimi: <http://bit.ly/1A7MvVw>

<sup>13</sup> Raport Vjetor: Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2013, Enti i Rregullatorit të Energjisë, 2013. Burimi: <http://bit.ly/1s3EI63>

Në rastin e Kosovës, kjo reflektohet tek jo-efiçienca dhe kostot e larta të operimit të tregut, ku kërkesa varion ndërsa sistemi gjenerues është shumë jo-fleksibil për të ndjekur kërkesën në të gjitha kohët. Gjithashtu, në kohët e pikut, kapacitetet prodhuese janë të pamjaftueshme për mbulimin e kërkesës, gjë e cila reflekton shpesh në import të energjisë me çmime shumë të larta apo në shkyçje të konsumatorëve. Në anën tjetër, në rastin e Shqipërisë, situata është pak më mirë. Fleksibiliteti i hidrocentraleve e lehtëson ndjekjen e kërkesës së ndryshueshme, mirëpo shfrytëzimi i energjisë së ujit për përmbushje të kërkesës bazë (base load) ul potencialin e shfrytëzimit më ekonomik të atij burimi. Ndërsa mungesa e diversifikimit në të dy sistemet, i bën ato të ndjeshme dhe të dobëta ndaj faktorëve të jashtëm, si klima dhe reshjet atmosferike.


## 2.2 Mundësitë dhe përfitimet nga bashkëpunimi

Këto karakteristika i bëjnë të dy sistemet shumë komplementare. Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, apo edhe krijimi i një tregu të përbashkët, do të shfrytëzonte përparësitë e të dy sistemeve dhe do të eliminonte disa nga mangësitë. Kosova do të zgjidhte në masë të madhe problemin e mungesës së kapaciteteve për mbulimin e pikut të ngarkesës, ndërsa Shqipëria do të shfrytëzonte energjinë bazë të Kosovës në mënyrë që të kontrollojë rezervat ujore të hidrocentraleve. Ndërsa, bashkëpunimi do të optimizonte përdorimin e të dy burimeve, gjë e cila do të ulte rrezikun nga ndikimet e jashtme.

Mundësi tjetër përfitimi nga bashkëpunimi ndërmjet të dy sistemeve është edhe krijimi i një tregu më të madh dhe fleksibil, i cili do të lejonte arritjen e *ekonomisë së shkallës* tek operatorët ekonomik dhe integrimin e më shumë burimeve të ripërtrishme të energjisë. Një ndër të metat në integrimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë në sistemin energjetik është paparashikueshmëria e tyre, si rrjedhojë e paparashikueshmërisë së kushteve të jashtme si shpejtësia e erës apo rrezatimi i diellit, gjë e cila e vështirëson planifikimin plotësimin të kërkesës. Mirëpo, në një treg më të madh kjo gjë bëhet shumë më e lehtë. Gjithashtu, fleksibiliteti i hidrocentraleve të Shqipërisë mundëson lehtësisht integrimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë.

Potenciali i bashkëpunimit shihet qartë edhe tek çmimet mesatare që të dy vendet paguajnë për eksport dhe import të energjisë elektrike. Në tabelën e mëposhtme, linjat e plota tregojnë për çmimin mesatar të eksportit ndërsa ato të thyerat tregojnë për çmimin mesatar të importit; linjat në ngjyrë të kuqe janë të dhënat për Kosovën, ndërsa ato të zezat të dhënat për Shqipërinë. Ndërsa në mesataren e çmimit

të energjisë janë llogaritur vetëm çmimet e importit dhe eksportit të të dy vendeve me palët e treta, pasi që ndërmjet vete ato shkëmbejnë energji bazuar në marrëveshje. Siç mund të shihet, ekziston një hapësirë e madhe ndërmjet çmimeve të eksporteve të Kosovës dhe importeve të Shqipërisë, dhe çmimeve të eksporteve të Shqipërisë dhe importeve të Kosovës. Nën regjimin e një bashkëpunimi më të madh apo të një tregu të përbashkët, kjo hapësirë do të ishte shumë më e vogël, duke konsideruar përfitimet në çmime që të dy vendet kanë.



Burimi: Open Data Albania<sup>14</sup>; Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

### 2.3 Bashkëpunimi institucional

Duke u bazuar në karakteristikat e dy sistemeve dhe përfitimet potenciale, bashkëpunimi energjetik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ka qenë një ndër temat më të përfolura dhe jo-kontraverse gjatë dekadës së fundit. Komplementariteti i sistemeve ka bërë që të mos ketë pothuajse fare polemika apo debate sa i përket përfitimeve që këto dy sisteme do t'i kishin në rast bashkëpunimi. Gjithashtu, ka pasur edhe pajtueshmëri të plotë deklarative ndërmjet institucioneve të të dy vendeve sa i përket idesë së bashkëpunimit në fushën e energjisë, përkundër faktit që në praktikë gjërat kanë ecur me ritëm të ngadaltë. Këtë e tregon edhe fakti që pothuajse në të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me energji përmendet dhe mbështetet

<sup>14</sup> Burimi primar paraqet vlerat e eksportit dhe importit në valuten e Shqipërisë, në Lek. Për t'i bërë të krahasueshme vlerat në Lek janë kovertuar në Eurocent duke përdorur normën e konvertimit në: <http://bit.ly/1w4BgaW>



ideja e bashkëpunimit energjetik të dy vendeve dhe përkrahet ideja për ndërtimin e linjës së interkoneksionit 400 kV si mënyrë e lidhjes së dy tregjeve energjetike.

Së fundmi, është përfolur shumë edhe rreth krijimit të një tregu të përbashkët Kosovë - Shqipëri. Në draft-strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2013-2022, parashihet bashkëpunimi i thellë me Shqipërinë dhe opsioni për krijimin e një tregu të përbashkët.<sup>15</sup> Një bashkëpunim i tillë është paraparë edhe në strategjitë e Shqipërisë që nga viti 2003.<sup>16</sup>

Në anën tjetër, ministrat përgjegjës për energjetikë në të dy vendet kanë deklaruar që momentalisht është duke u punuar në krijimin e një tregu të përbashkët dhe që shumë shpejtë do të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi.<sup>17</sup> Në ndërkohë, shumë marrëveshje në mes të Kosovës dhe Shqipërisë vazhdojnë të aplikohen sic janë: Marrëveshja e Mirëkuptimit për Bashkëpunim në mes të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) së Shqipërisë dhe Ministrisë së Energjisë dhe Minerave (MEM) së Kosovës; Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) së Shqipërisë dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) së Kosovës; Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Operatorit të Transmisionit dhe Tregut (OST) të Shqipërisë dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) të Kosovës; dhe, Marrëveshja për Shkëmbim të Energjisë Elektrike në mes të Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).<sup>18</sup>

Bashkëpunimi intensiv apo edhe krijimi i një tregu të përbashkët energjetik gjithashtu do të ishte konform bazës ligjore dhe në frymë të politikave të Komunitetit të Energjisë, anëtarë të së cilës janë edhe Kosova edhe Shqipëria. Sipas Traktatit formues të Komunitetit të Energjisë, një ndër arsytet e themelimit të tij është “zhvillimi i konkurrencës së tregut në rrjetin energjetik të një shkalle më të madhe gjeografike dhe shfrytëzimi i ekonomisë së shkalles”.<sup>19</sup>

<sup>15</sup> Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2013 - 2022. Burimi: <http://bit.ly/1Bsxs6y>

<sup>16</sup> Shih Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2003, dhe Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2013-2020.

<sup>17</sup> MZHE. Marrëveshjet Kosovë-Shqipëri në fazën e implementimit. Burimi: <http://bit.ly/1CY15yn>. Koha.net: Gjikhuri: Interkonjeksiioni Shqipëri - Kosovë, vepër që do të realizohet. Burimi: <http://bit.ly/1BsxCLe>

<sup>18</sup> KOSTT and development of the PS, challenges versus market development. Fadil Ismajli. Burimi: <http://bit.ly/1wRgihk>

<sup>19</sup> Traktati për Themelimin e Komunitetit të Energjisë. Burimi: <http://bit.ly/ORIAFK>

Përveç bashkëpunimit në aspektin e krijimit të infrastrukturës për shkëmbim të energjisë dhe liberalizimit të tregut për të dyja vendet, bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ka ngecur në nënshkrimin e marrëveshjeve për ujërat. Ndërtimi i hidrocentralit të Zhurit në Kosovë do të ndikojë në rrjedhën e lumenjve edhe në Shqipëri.<sup>20</sup> Për këtë arsye duhet nënshkruar marrëveshje sa më shpejtë që rregullojnë shfrytëzimin e ujërave për nevoja energjetike dhe për fillimin e projektit të Zhurit.

### 3. Efektet anësore të bashkëpunimit: shqetësimet për ambientin

Duke pasur parasysh komplementaritetin e të dy sistemeve, potencialin e Shqipërisë për të ndërtuar më shumë kapacitete të bazuara në ujë dhe rezervat e mëdha të linjtit në Kosovë, do të mund të dukej logjike të mendohet që të dy vendet duhet të zhvillojnë avantazhet e tyre krahasuese. Pra, që Kosova të zhvillojë edhe më tej kapacitetet e bazuara në linjit, kurse Shqipëria në hidro, dhe kështu të eksploatohen përparësitë krahasuese në maksimum në të dy vendet.

Në një përfundim të tillë vjen edhe studimi i Vattenfall për sigurinë e energjisë elektrike në Kosovë, studim i cili është kontraktuar nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT).<sup>21</sup> Ky studim merr parasysh disa skenarë të sigurisë së energjisë elektrike në Kosovë, dhe mundësinë e krijimit të një tregu të përbashkët me Shqipërinë. Skenari me përfitime më të mëdha energjetike për të dy sistemet rezulton të jetë eksploatimi i madh i linjtit në Kosovë dhe liberalizimi i tregut me Shqipërinë në mënyrë që të shfrytëzohet komplementariteti i sistemeve. Në bazë të këtij skenari, rekomandohet ndërtimi i termocentralit Kosova e Re me kapacitet prej 600 MW dhe ndërtimi i dy termocentraleve tjera me kapacitet 600 MW secili. Në këtë mënyrë, Kosova do të kishte 1800 MW kapacitete të reja të bazuara në linjit deri në vitin 2030.

Mirëpo, kjo mënyrë e të menduarit nuk është plotësisht racionale dhe dështon në llogaritjen e kostos së ndikimeve negative eksternale që vijnë nga termocentralet. Ndonëse propozimi për eksploatimin e linjtit në kapacitete të mëdha ka kuptim të ngushtë energjetik – pra

<sup>20</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Review Of Hpp Zhur Feasibility Study Including Preparation Of Preliminary Environmental Impact Assessment And Preliminary Social Assessment. Burimi: <http://bit.ly/1BsxQ51>

<sup>21</sup> Study about Security of Electricity Supply in Kosovo. Vattenfall Europe PowerConsult GmbH. Burimi: <http://bit.ly/1sbpaHI>

duke marrë parasysh vetëm kilovatët e prodhuar dhe shkëmbyer – ndikimet negative të eksternaliteteve duhet gjithashtu të faktorizohen në përlllogaritjen e përfitimeve. Kësisoj, duhet llogaritur ndikimi i ndotjes së ambientit nga pluhuri dhe gazrat që lirohen me rastin e djegies së linjit, ndikimet në shëndetin publik të ndotjes, dhe ndikimet në jetën e individëve dhe familjeve që duhet zhvendosur për ndërtimin e termocentraleve të reja dhe hapjes së minierave të reja të linjtit. Ndotja e ajrit, në të cilën kontribuojnë në pjesën më të madhe termocentralet Kosova A dhe B, llogaritet të jetë shkaktari i rreth 835 vdekjeve të parakohshme, 310 rasteve të reja të bronkitit kronik, 600 shtrirjeve në spital dhe 11.600 vizitave në emergjencë në çdo vit.<sup>22</sup> E gjithë kjo, e shprehur në shumë monedha, i kushton Kosovës rreth 100 milion euro në vit.<sup>23</sup>

Në këtë aspekt, edhe studimi nga Vattenfall i cili ka pasur ndikim të madh në idenë e krijimit të një tregu të përbashkët në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2013-2022<sup>24</sup>, dështon të merr parasysh ndikimet negative të eksternaliteteve të kapaciteteve të reja të propozuara të bazuara në linjit. Ndonëse në studim bëhet përlllogaritja e emetimit të gazrave dhe pluhurit, ato nuk përlllogariten më tej në modelim të skenarëve.

Si përfundim, përkundër përmirësimit të teknologjisë, për momentin ende nuk ka termocentral të bazuar në linjit i cili nuk shkakton ndotje dhe nuk emeton gazra.<sup>25</sup> Pra, edhe bazimi nën një supozim që në të ardhmen do të përmirësohet teknologjia e gjenerimit të energjisë elektrike në bazë në linjit është i paqëndrueshëm dhe rrezikon të largohet fokusi në zhvillimin e energjisë së pastër.

---

<sup>22</sup> World Bank. Country Environmental Analysis: Cost Assessment of Environmental Degradation, Institutional Review, and Public Environmental Expenditure Review. Burimi: <http://bit.ly/1CY2d52>.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2013 - 2022. Burimi: <http://bit.ly/1Bsxs6y>

<sup>25</sup> Teknologjia për kapjen dhe gënjatjen e karbonit është ende në testim, por shenjat e para kanë qenë negative. Gjithashtu, një teknologji e tillë kushton shumë dhe edhe sikur të ishte e mundur do të ishte e papërbashkueshme për qytetet e Kosovës.

## 4. Përfundim dhe rekomandime

Bashkëpunimi në fushën e energjisë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është i kufizuar, përkundër faktit që të dy sistemet janë shumë komplementare. Një ndër faktorët kyç për këtë kufizim ishin marrëdhëniet jo të mira politike ndërmjet këtyre vendeve gjatë kohës kur ishin ndërtuar sistemet energjetike të të dy vendeve (vitet '60-ta). Megjithatë, kjo situatë është duke ndryshuar.

Sistemi energjetik i Kosovës i bazuar pothuajse krejtësisht në linjit, mund të shërbejë për furnizimin e energjisë baze, kurse sistemi energjetik i Shqipërisë mund të shërbejë si furnizues i energjisë së pikut. Në këtë mënyrë do të optimizohen dhe ekonomizohen sistemet energjetike të të dy vendeve. Në të kundërtën, është shumë e kushtueshme që, në rastin e Kosovës, të përcjellët përmbushja e energjisë së pikut me termocentrale jo-fleksibile të linjtit, ndërsa në rastin e Shqipërisë të përdoret energjia hidrike për furnizimin e energjisë baze. Përveç këtyre përfitimeve, bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve gjithashtu zvogëlon mundësinë e ndikimeve negative nga faktorë të jashtëm, në mungesë të diversifikimit të resurseve, si kushtet klimatike, mungesa e reshjeve atmosferike, apo ndryshimet e pa pritshme në prodhimin e linjtit.

Duke i pasur parasysh këto përfitime nga bashkëpunimi energjetik i të dy vendeve, qeveritë e të dy vendeve planifikojnë intensifikimin e bashkëpunimit energjetik. Kjo shihet qartë edhe në deklaratimet e tyre në strategjitë e energjisë së të dy vendeve. Mirëpo, përkundër deklaratimeve të institucioneve të të dy vendeve në favor të bashkëpunimit, projektet konkrete, si ndërtimi i linjës interkonjektive 400 kV, ishin shtyrë disa herë dhe vonesa e realizimit të tyre vetëm sa ka penguar bashkëpunimin energjetik të të dy vendeve. Bashkëpunimi gjithashtu ka ngecur sa i përket marrëveshjeve për përdorimin e ujërave ndërkuftar për qëllime të ndërtimit të kapaciteteve energjetike mbi to.

Edhe pse përfitimet nga bashkëpunimi energjetik i të dy vendeve janë të pa-kontestueshme, Kosova duhet të ketë kujdes në ndërtimin e kapaciteteve të reja në bazë në qymyr. Përkundër faktit që qymyri i Kosovës është shumë kompatibil me resurset ujore të Shqipërisë, Kosova duhet të marrë parasysh edhe ndikimet negative të eksternaliteteve të djegies së qymyrit, si ndotja e ambientit nga pluhuri dhe gazrat, ndikimi negativ i ndotjes në shëndetin publik, dhe ndikimi negativ i zhvendosjes së popullsisë nga hapja e minierave të qymyrit dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja.

Duke pasur parasysh fleksibilitetin e hidrocentraleve të Shqipërisë dhe krijimin e një tregu më të madh të energjisë nga bashkimi i të dy tregjeve, Kosova duhet të zhvillojë dhe ndërtojë kapacitete të reja të energjisë së ripërtrishme. Paparashikueshmeria e disponueshmerisë së burimeve të ripërtrishme mund të balancohet lehtë me fleksibilitetin e kapaciteteve hidrike të Shqipërisë.

Duke u bazuar ne këto përfundime, Instituti GAP rekomandon:

- Bashkëpunimi energjetik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë duhet të intensifikohet edhe më tej me ndihmën e qeverive të të dy vendeve. Ky bashkëpunim duhet të rezultojë në:
  - Krijimin e një tregu të përbashkët të energjisë;
  - Konkretizimin e planeve strategjike për bashkëpunim energjetik ndërmjet të dy vendeve;
  - Luftimin e pengesave të bashkëpunimit energjetik, si korrupsioni;
  - Nënshkrimi i marrëveshjes së ujërave ndërkufitar për përdorim energjetik.
- Përlogaritjen e ndikimeve negative eksternale të kapaciteteve të bazuara në linjit dhe limitimin e përdorimit të tyre përkundër komplementaritetit me burimet hidrike të Shqipërisë.
- Stimulimin dhe zhvillimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.